



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Lënda: Njoftim për shtesë të Dokumenteve të Procedurës Konkurruese si dhe për zgjatje të afatit kohor për dorëzimin dhe hapjen e ofertave të procedurës konkurruese për dhënien me koncesion/PPP të portit turistik dhe të shërbimeve “Marina Limion”, propozim i kërkuar

Agjencisë së Prokurimit Publik

Blvd: “Dëshmorët e Kombit”, Pranë Këshillit të Ministrave, Tiranë

Në zbatim të nenit 24, pikave 3 dhe 7, të Ligjit nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat” i ndryshuar, nenit 42 pika 2 e Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, VKM-së nr. 130 datë 12.3.2014 “Për kryerjen në mënyrë elektronike të procedurave konkurruese të koncesionit/ partneritetit publik privat”, dhe në nënparagrafin 2.3.1. të pikës 2.3. “Ndryshime në dokumentet e procedurës konkurruese”, Autoriteti Kontraktues, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, njofton të gjithë operatorët ekonomikë se bën këto shtesa në Dokumentet e Procedurës Konkurruese për dhënien me koncesion/PPP të portit turistik dhe të shërbimeve “Marina Limion”, propozim i kërkuar, si vijon:

1. Pas gurmës “c.” të pikës 1.1. “Informacion i përgjithshëm” nën seksionin II. Udhëzime për ofertuesit, të shtohet pika e. “Kushte të tjera të lidhura me objektin” me këtë përmbajtje:

e. “Kushte të tjera të lidhura me objektin”

Ofertuesit, gjatë hartimit të ofertës për procedurën konkurruese për dhënien me koncesion/PPP të portit turistik dhe të shërbimeve “Marina Limion”, duhet të kenë parasysh Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 226, datë 26.4.2018 “Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si qiradhënës, dhe shoqërisë “Concord Investment” sh.p.k., si qiramarrës, për pasurinë “pjesë të ambienteve të Portit të Limionit”, Sarandë, me nr. pasurie 5/232, zona kadastrale 8641, me sipërfaqe të përgjithshme 5 370 m², në përgjegjësi administrimi të Portit Detar, sha, Sarandë”.

2. Tek shtojca 13 “Projekti i zbatimit dhe specifikimet teknike” tek seksioni “Projekti i portit duhet të parashikojë minimalisht, por pa u limituar edhe:” të shtohen pikat e mëposhtme:
 - Infrastrukturë për ngarkim shkarkim e anijeve tregtare (mallrave);
 - Infrastrukturë për mirëmbajtje periodike dhe riparime defektesh të mjeteve të lundrimit dhe anijeve.

Si rrjedhë, afati kohor për dorëzimin e ofertave:

Brenda dhe jo me vonë se: Data: **2/9/2019** Ora: **14:00 A.M.**

Oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike operatorët ekonomike duhet të dorëzojnë ofertën në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP-së, www.app.gov.al

Afati kohor për hapjen e ofertave:

Brenda dhe jo me vonë se: Data: **2/9/2019** Ora: **14:00 A.M.**

Ju faleminderit për mirëkuptimin.